



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:900537
Datë: 17.03.2025
Numri i dokumentit: 07002331

C.nr.606/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve S. N. K, A. M., A. K., A. F., E. M., Z.P., A.I., O.H., SH.B. dhe I.J., të gjithë nga M., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson A.L., avokat nga M., kundër të paditurës Komuna e M., në M., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.Z., avokat nga P., me objekt kontesti pagesën e paushallit mujor, në seancën e datës 04.03.2025 mori, ndërsa më datë 17.03.2025 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET** e tërhequr padia e paditësve S. N. K, A. M., A. K., A. F., E. M., Z.P., A.I., O.H., SH.B.dhe I.J., të gjithë nga M., e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, në M., me objekt kontesti pagesën e paushallit mujor, në këtë çështje juridike kontestimore.
- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit S. N. K, A. M., A. K., A. F., E. M., Z.P., A.I., O.H., SH.B .dhe I.J., të gjithë nga M., në këtë gjykatë kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, në Mitrovicë, me objekt kontesti pagesën e paushallit mujor.

I autorizuari i paditësve me parashtrësën e datës 10.09.2022, e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë dhe kërkesëpadinë në këtë çështje juridike, dhe poashtu në seancën gjyqësore të caktuar nga kjo gjykatë lidhur me këtë çështje më datë 04.03.2025, në të cilën nuk ka prezentuar i autorizuari i paditësve përkundër faktit se i njëjti ka qenë i ftuar me rregull për këtë seancë gjyqësore dhe mosprezencën nuk e ka arsyetuar, i autorizuari i të paditurës i cili i është përgjigjur ftesës së gjykatës ka deklaruar se nuk e kundërshton tërheqjen e padisë së paditësve, andaj edhe gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 261 par.2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), e cila përcakton se: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. ...”* dhe par.3 të po kësaj dispozite ligjore, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*, vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së, pasi që asnjëra palë nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.606/2022 më datë 17.03.2025

G j y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.